


# KURRIKULA E EKONOMISË QARKULLUESE



## NJË MODEL PEDAGOGJIK PËR TË PËRFSHIRË KOMPETENCAT E EKONOMISË QARKULLUESE NË ARSIM



Projekt i financuar nga Bashkimi Evropian



Zbatuar nga Qendra për Aftësi Konkurruese

Ky dokument është mundësuar nga mbështetja financiare e Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi vetëm e Qendrës për Aftësi Konkurruese (Center for Competitive Skills), dhe nuk mund të konsiderohet në asnjë rrethanë se pasqyron qëndrimin e Bashkimit Evropian.



## Hyrje

Kalimi drejt një ekonomie qarkulluese është një nga sfidat më të mëdha nëse duhet të krijohet një shoqëri të qëndrueshme. Ky tranzicion kërkon një qasje ndërdisiplinore, duke kombinuar konsideratat sociale, teknike, menaxheriale dhe mjedisore. Koncepti i Ekonomisë Qarkulluese është një përgjigje ndaj aspiratës për rritje të qëndrueshme në kontekstin e presionit në rritje ndaj prodhimit dhe konsumit në një planet me burime natyrore të fundme.

Sot ekonomia jonë është krijuar për të nxjerrë lëndë të parë nga natyra, për t'i përpunuar ato në mallra të përdorshëm dhe më pas për t'i hedhur ato në një fushat e depozitimit të mbetjeve, apo për ti djegur në incenerator ose diku i flasur si rastësisht në natyrë. Ky sistem linear "merr – përdor – hidh" ka rezultuar krejt i dështuar dhe humbjet rezultojnë me një ndikim negativ në mjedis, i cili aktualisht nuk llogaritet dhe nuk faturohet në asnjë nga mënyrat tona të matjes ekonomike.

Alternativa ndaj ekonomisë lineare është ekonomia qarkulluese, e cila ka të bëjë me rikonceptimin e mënyrës së prodhimit të mallrave dhe shërbimeve në mënyrë që ato të plotësojnë nevojat tona në mënyra më të qëndrueshme dhe rigjeneruese.

Rruga drejt zhvillimit të Ekonomisë Qarkulluese do të ketë një efekt të thellë në tregun e punës dhe zhvillimin e aftësive të reja tek të gjithë njerëzit por sidomos të rinjtë. Tashmë tranzicioni ekonomik drejt një ekonomie qarkulluese kërkon me një nevojë të ngutshme aftësi, kompetenca dhe qasje të reja. Edukimi, trajnimi profesional fillestar dhe i vazhdueshëm dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës kanë një rol kritik në formësimin azhurnimin e këtyre aftësive të domosdoshme për zhvillim të qëndrueshëm.



Kjo kurrikul e Ekonomisë Qarkulluese kërkon të japë njohuritë bazë në lidhje me këtë lloj ekonomie duke u përpjekur që të krijojë disa kompetenca të rëndësishme për të kaluar nga një ekonomi lineare, aspak e qëndrueshme, në një ekonomi qarkulluese. Të mësuarit mbi ekonominë qarkulluese nxit tek nënësit kopetencat e novacionit dhe kerativitetit duke përdorur një qasje interesante mbi sistemet dhe të menduarin në sistemik duke marrë parasysh këtu perspektivat e ndryshme të palëve të interesit, strukturat aktuale të zhvillimit të ekonomisë dhe ndikimet e alternativave të ndryshme të ekonomisë qarkulluese mbi burimet e fundme natyrore të planetit.

## **Rruga drejt zhvillimit të Ekonomisë**

**Qarkulluese do të ketë një efekt të thellë në tregun e punës dhe zhvillimin e aftësive të reja tek të gjithë njerëzit, por sidomos të rinjtë.**



## *Strategjitë udhëzuese që janë veçanërisht të efektshme në programi arsimor për Ekonominë Qarkulluese përfshijnë:*

- të mësuarit në bashkëpunim diskutim ne grup
- studim i pavarur
- zhvillimi i portofolit
- ditare dhe regjistra mësimi
- lojë me role
- organizatorët njohës
- përgjigja e letërsisë
- të mësuarit e shërbimeve
- hetim i bazuar në çështje.



## Rezultatet e të nxënit

Pas përfundimit të këtij moduli nxënësi do të:

- kuptojë konceptin e një Ekonomie Qarkulluese, bazuar në karakteristikat e tij sociale, teknologjike, menaxheriale dhe mjedisore;
- kuptojë se si një ekonomi qarkulluese ndryshon nga sistemi aktual it ë bërit ekonomi i cili është kryesisht linear;
- analizojë elementët përbërës të një sistemi qarkulluese;
- vlerësojë dhe përdor Analizën e Ciklit të Jetës së produkteve dhe shërbimeve në kontekstin e ekonomisë qarkulluese dhe ti zbatoni ato në një rast studimor;
- krijojë aftësi të reja krijuese dhe novatore të dizanjit dhe eko-dizanjit për një ekonomi qarkulluese

# Moduli 1: Hyrje në Ekonominë Qarkulluese

Përshkrimi i modulit:

*Ky modul shërben për të prezantuar ekonominë qarkulluese dhe jep një prezantim të parë në lidhje me parimet kryesore në të cilat ajo mbështetet si dhe përkufizimet e Ekonomisë Qarkulluese.*

Tema 1.1 - Hyrje në Ekonominë Qarkulluese (2 orë)

Tema 1.2 - Partimet e Ekonomisë lineare dhe asaj qarkulluese

Tema 1.3 - Çfarë ka të re në të menduarit në Ekonomisë Qarkulluese (2 orë)

Tema 1.4 - Shpjegimi i Ekonomisë Qarkulluese sipas modelit flutur (3 orë)

# Moduli 2: Nxitja e Ekonomisë Qarkulluese

Përshkrimi i modulit:

*Ky modul përqëndrohet në zhvillimin e aftësive për sistemet qarkulluese dhe ofron informacione praktike. Ai prezanton konceptin e të menduarit në sistem. Një qasje sistematike ndaj problemeve dhe situatave është e nevojshme kur duhet të merremi me sisteme komplekse.*

Tema 2.1 - Vlerësimi i ciklit jetësor të produkteve (cikli biologjik & teknik) (3 orë)

Tema 2.2 - Cikli i jetës së letrës, qelqit, plastikës dhe metalit (4 orë)

Tema 2.3 - Ripërdorimi (4 orë)

Tema 2.4 – Riciklimi (3 orë)

Tema 2.5 - Cikli i lëndës organike (2 orë)

Puna me projekt - Projekte kërkimore në lidhje me konsumin dhe mbetjet në vend dhe Evropë (2 orë)

# Moduli 3: Zbatimi praktik i Ekonomisë Qarkulluese

Përshkrimi i modulit:

*Në këtë modul, do të studiohen sfidat e burimeve natyrore, natyra e materialeve dhe rëndësia e modelimit të produktit për një ekonomi qarkulluese.*

*Ky modul përqëndrohet në vënien në zbatim të Ekonomisë Qarkulluese, duke i nxitur nxënësit të mendojnë në mënyrë krijuese dhe novatore në lidhje me Ekonominë Qarkulluese*

Tema 3.1 - Dizajn për një ekonomi qarkullues, rëndësia e modelit të produktit për një ekonomi qarkulluese (2 orë)

Tema 3.2 - Eko-dizajn dhe dizajni i frymëzuar nga natyra (2 orë)

Tema 3.3 - Natyrën e materialeve (2 orë)

Tema 3.4 - Vlera e biznesit në Ekonominë Qarkulluese (2 orë)

Tema 3.5 - Sipërmarrja e gjelbër (2 orë)

Puna me projekt - Projekte kërkimore në lidhje me praktikën e Ekonomisë Qarkulluese në botë (3 orë)



**Totali i orëve mësimore 40 orë**